



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.19**

**17 mars**

**2012**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Udhëzim i MF nr.3, datë 21.2.2012	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 19, datë 1.9.2010 “Për modalitetet e aplikimit të pullave të akcizës dhe pullave fiskale në produktet e duhanit, birrës dhe alkoolit” .....	775
Vendim i GJK nr.10, datë 1.3.2012	Me objekt: Konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda afatit të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).....	777
Vendim i GJK nr. 11, datë 2.3.2012	Me objekt: Konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 484, datë 20.9.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë; - Shfuqizimin e vendimit nr. 102, datë 18.3.2011 të Gjykatës së Lartë.....	782
Vendim i GJK nr.12, datë 5.3.2012	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm.....	788

**UDHËZIM**  
**Nr. 3, datë 21.2.2012**

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 19, DATË 1.9.2010 “PËR MODALITETET  
E APLIKIMIT TË PULLAVE TË AKCIZËS DHE PULLAVE FISKALE NË PRODUKTET E  
DUHANIT, BIRRËS DHE ALKOOLIT”**

Bazuar në nenin 55 paragrafi 1, germa “g” të ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ministri i Financave

**UDHËZON:**

Në udhëzimin nr. 19, datë 1.9.2010 “Për modalitetet e aplikimit të pullave të akcizës dhe pullave fiskale në produktet e duhanit, birrës dhe alkoolit” bëhen këto ndryshime:

1. Pika 5.1 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“5.1. Secili prodhues dhe/ose importues, jo më vonë se në ditën e shtatë të punës të çdo muaji janar, prill, korrik dhe tetor të çdo viti, ose në atë ditë që furnitori dhe prodhuesit bien dakord, duhet t’i japë autoritetit:

- me anë të sistemit qendror të monitorimit të gjurmëve dhe shenjave; ose

- duke plotësuar formularin dhe dorëzimin e tij tek autoriteti, në mënyrë elektronike ose me shkrim,

një parashikim, ku të parashtrohet numri i pullave të akcizës dhe i pullave fiskale që kërkohen të jenë të vlefshme në PCC për çdo importues/prodhues, së bashku me detaje të tjera siç kërkohet për çdo porosi. Çdo parashikim duhet të përmbajë këtë informacion për çdo muaj gjatë periudhës së tre muajve të njëpasnjëshëm, duke filluar me muajin e parë, menjëherë pas muajit në të cilin është kërkuar të dorëzohet parashikimi (p.sh. një parashikim i dhënë në janar duhet të mbulojë muajt shkurt deri në prill). Gjithashtu, çdo parashikim do të përfshijë edhe parashikimin vjetor të vitit kalendarik aktual dhe duke filluar nga parashikimi i muajit korrik, do të përfshijë edhe parashikimin vjetor të vitit pasardhës. Kjo procedurë kryhet sipas formatit dhe të dhënave të shtojcës 6 bashkëlidhur këtij udhëzimi.”.

2. Në pikën 5.2, shkronja “a” ndryshohet me këtë përmbajtje:

“5.2 Porositja dhe faturimi i pullave të akcizës

a) Për çdo porosi të pullave të akcizës, një prodhues ose importues, jo më vonë se 15 ditë pune para datës në të cilën synon të tërheqë (vetë) ose të inspektojë (përpara eksportimit) një porosi në PCC, duhet të kryejë porosinë:

i) me anë të sistemit qendror të monitorimit të gjurmëve dhe shenjave, të mundësuar nga autoriteti; ose

ii) duke plotësuar formularin e lëshuar nga autoriteti për këtë qëllim dhe dorëzimit të këtij formulari tek autoriteti, në mënyrë elektronike ose me shkrim. Çdo porosi duhet të specifikojë llojin e produktit që kërkon pullë akcize, vëllimin e njësisë së produktit prodhim vendi/importi dhe sasinë e pullave të akcizës të kërkuara, sikurse përshkruhet në shtojcën 2 pika 1, duke respektuar sasinë minimale të porosisë dhe shtesat mbi sasinë minimale (sipas përcaktimeve të shtojcës 2 pika 2). Autoriteti duhet t’i miratojë porositë brenda 1 dite punë nga marrja e secilës porosi me anë të sistemit qendror të monitorimit të gjurmëve dhe shenjave. Brenda 2 ditëve pune nga marrja e porosisë nga prodhuesi/importuesi, autoriteti duhet të njoftojë furnitorin me anë të sistemit qendror të monitorimit të gjurmëve dhe shenjave, që kjo porosi është miratuar.”.

3. Në pikën 5.2, shkronjat “e” dhe “f” ndryshohen me këtë përmbajtje:



“e) Dërgimi i pullave të akcizës tek importuesi: Për sa u përket porosive që furnitori i ka konfirmuar një importuesi, ai do t’ia dorëzojë pullat e akcizës një agjenti dërgesash me reputacion për dërgim të marrësi. Furnitori u shet pulla akcize importuesve, me kushtet e dërgesës në destinacion DAP (sipas INCOTERMAVE 2010), duke përfshirë TVSH-në, por duke përfshirë edhe tarifatat për transportin, sigurinë dhe siguracionin. Fatura duhet të përmbajë edhe adresën e palës marrëse. Furnitori ia dërgon pullat e akcizës agjentit të dërgesës. Importuesi ka të drejtën të jetë i pranishëm kur pullat e akcizës të pakëtohen dhe ngarkohen për t’u dërguar tek agjenti i dërgesës. Detyrimet lokale dhe taksat e importit paguhën në destinacion nga marrësi, sipas legjislacionit lokal doganor. Secilit importues do t’i kërkohet të japë te furnitori, me shkrim ose me anë të sistemit qendror të monitorimit të gjurmëve dhe shenjave, emrin dhe numrin e telefonit të secilit person të autorizuar nga ky importues për të verifikuar dhe pranuar cilësinë (vetëm për defekte/dëmtime të dukshme) dhe sasinë e pullave të akcizës përpara dorëzimit të këtyre pullave tek agjenti i dërgesës.

f) Furnitori i konfirmon autoritetit, një ditë mbas miratimit të porosisë së pullave të akcizës prej këtij të fundit për çdo importues, vlerën e kostos së dërgesës dhe kostot e lidhura me të (pika 3 e nenit 24/2 të ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar).

Kur:

1. prodhuesi t’i parapaguajë furnitorit çmimin e pullës së akcizës;  
2. importuesi t’i parapaguajë furnitorit çmimin e pullës së akcizës, vlerën e kostos së dërgesës dhe kostot e lidhura me të, në përputhje me pikat 3 dhe 4 të nenit 24/2 të ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

atëherë furnitori përgatit faturën, ku është specifikuar:

i) për prodhuesin, shumën në euro (dhe shumën e konvertuar në lekë, me kursin e ditës së lëshimit të faturës, publikuar nga Banka e Shqipërisë), sipas parapagimit të bërë;

ii) për importuesin, shumën në euro (dhe shumën e konvertuar në lekë, me kursin e ditës së lëshimit të faturës, publikuar nga Banka e Shqipërisë), sipas parapagimit të bërë;

iii) për prodhuesin/importuesin, shumën e TVSH-së së llogaritur; dhe

iv) Numrin e llogarisë në Shqipëri, në të cilin do të bëhet pagesa.”.

4. Në pikën 5.2, në shkronjën “h” në paragrafin e dytë, fjalja e parë ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Në rast të identifikimit të defekteve të produktit nga marrësi, në jo më shumë se 10 ditë të punueshme nga dita që ka marrë pullat, ky i fundit duhet të informojë furnitorin me shkrim, se janë identifikuar pulla akcize defektoze.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE

**Ridvan Bode**

**VENDIM**  
**Nr. 10, datë 1.3.2012**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Petrit Ploçi	Anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare	e	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar	i	“	“
Admir Thanza	Anëtar	i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“

me sekretare Enina Mullaj, në datën 17.10.2011 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen nr. 37/13 akti, që i përket:

**KËRKUES:** Elvin Lako

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:** Këshilli i Ministrave, përfaqësuar me autorizim nga Abaz Deda dhe Elona Dade.

Zyra e përmbarimit Tiranë, në mungesë.

Shoqëria përmbarimore “EPSA” sh.p.k., në mungesë.

**OBJEKTI:** Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda afatit të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 131/f dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i KEDNJ-së.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberi, kërkuesin që kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesit e subjektit të interesuar, që kërkuan rrëzimin e kërkesës, dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**I**

1. Kërkuesi ka qenë nëpunës civil (kategoria e pagës II-b) në pozicionin Inspektor në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsionit në Këshillin e Ministrave. Me aktin administrativ nr. 455/6, datë 20.2.2006, të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave kërkuesi është liruar nga shërbimi civil dhe është kaluar në listë pritjeje. Kërkuesi është ankuar në Komisionin e Shërbimit Civil (KSHC) ndaj këtij akti administrativ.

2. Me vendimin nr. 266, datë 27.4.2006, KSHC-ja ka vendosur pranimin e ankimit, shfuqizimin e akteve të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, rikthimin e kërkuesit në detyrë dhe pagimin e pagës nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në ekzekutimin e vendimit.



3. Këshilli i Ministrave i është drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. 297, datë 14.12.2006, ka vendosur rrëzimin e padisë së paraqitur nga Këshilli i Ministrave për shfuqizimin e vendimit të KSHC-së, si të pabazuar në ligj.

4. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2008-236, datë 15.2.2008, ka vendosur në Dhomë Këshillimi mospranimin e rekursit të paraqitur nga Këshilli i Ministrave.

5. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 137, datë 18.12.2008, ka vendosur lëshimin e urdhrorit të ekzekutimit për zbatimin e vendimit të formës së prerë nr. 297, datë 14.12.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

6. Zyra e Përmbarrimit Tiranë, fillimisht i është drejtuar Këshillit të Ministrave (debitorit) me lajmërim për ekzekutim vullnetar (shkresa nr. 734 prot., datë 16.1.2009) e më pas me vendim për ekzekutim të detyruar (shkresa nr. 1662 prot., 5.2.2009).

7. Këshilli i Ministrave në datën 20.1.2009 ka kaluar në llogarinë e përmbarruesit, për llogari të kërkuarit, detyrimin financiar për deri në atë datë, që konsistonte në: a) pagesën e pagës për një vit nga momenti i largimit deri në datën 2.3.2007; dhe b) pagesën e 22 pagave mujore të kategorisë II-b, nga data 2.3.2007 deri në datën 2.1.2009.

8. Në bazë të vërtetimit nr. 5/12324 prot, datë 26.5.2009 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë (DRT), si dhe shkresës nr. 1908 prot, datë 23.9.2009 të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë (DRSSH), për shumën e kaluar në llogarinë e përmbarruesit, Këshilli i Ministrave ka paguar kontribute vetëm për pjesën që i takon punëmarrësit, pa paguar pjesën që i takon punëdhënësit.

9. Zyra e Përmbarrimit, në datat 4.6.2009 dhe 19.5.2010 i është drejtuar debitort me dy kërkesa për ekzekutim të titullit ekzekutiv (konkretisht për pagesën e detyrimit financiar duke filluar nga data 1.2.2009 deri në ekzekutimin e vendimit dhe rikthimin në punë), të cilave debitori nuk u është përgjigjur.

10. Me hyrjen në fuqi të shërbimit për përmbarruesit privatë, kërkuari, në datën 27.1.2011 ka lidhur kontratë me shoqërinë përmbarrimore private "EPSA" sh.p.k. Përmbarruesi privat i ka nisur disa shkresa debitorit për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, të cilave debitori nuk u është përgjigjur.

11. *Kërkuari* i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (në vijim Gjykata), duke pretenduar se ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda fatit të arsyeshëm.

12. *Subjekti i interesuar*, Këshilli i Ministrave, ka pretenduar me shkrim dhe në seancë gjyqësore se:

12.1 Vendimi nr. 266, datë 27.4.2006, i KSHC-së është i pambështetur, i marrë në interpretim të gabuar të ligjit dhe si i tillë i pabazuar.

12.2 Kthimi në punë i kërkuarit, si pjesë e vendimit gjyqësor, është i pamundur, pasi për arsye të ristrukturimit, kriteret për vendin e punës në të cilin duhet të kthehet kërkuari kanë ndryshuar.

12.3 Rekrutimi i nëpunësve civilë duhet të mbështetet në besimin e punëdhënësit të punëmarrësi dhe nuk mund të jetë i detyruar, qoftë edhe nga një vendim gjyqësor. Kështu që mosekzekutimi i vendimit gjyqësor për rikthimin në punë të nëpunësve civilë, nuk sjell cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

12.4 Ekzekutimi i detyrimit financiar, sipas vendimit gjyqësor është i pamundur për arsye të mungesës së fondeve.

II

13. Gjykata vlerëson fillimisht pretendimet e përfaqësuesit të subjektit të interesuar, Këshilli i Ministrave, sipas së cilit vendimi nr. 266, datë 27.4.2006, i KSHC-së është i pambështetur, i marrë në interpretim të gabuar të ligjit dhe si i tillë i pabazuar. Në lidhje me këto pretendime, Gjykata çmon se ato i përkasin themelit të çështjes. Në rastin në shqyrtim, është evidente, se çështjet e themelit janë zgjidhur nga KSHC-ja dhe gjykatat kompetente. Vendimi që jep KSHC-ja ngjason me vendimin e dhënë nga gjykata e shkallës së parë, nisur nga tiparet e tij dhe fuqinë detyruese që ligjvënësi i ka dhënë në rastet kur ai nuk ankimohet (*shih vendimin nr. 2, datë 1.2.2011 të Gjykatës Kushtetuese i cili i referohet vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 24.1.2007*).

14. Nga materialet e paraqitura rezulton se vendimi i KSHC-së është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendim të formës së prerë, mbi bazën e të cilit është nxjerrë dhe urdhri i ekzekutimit. Vendimi që kërkohet të zbatohet ka marrë formë të prerë, prandaj këto pretendime të subjektit të interesuar nuk qëndrojnë. Vënia në dyshim e titullit ekzekutiv si dhe vendimit të formës së prerë, në bazë të të cilit është nxjerrë ky titull, nuk është e pranueshme në një gjykim të karakterit kushtetues, si në rastin konkret.

15. Në vijim të arsyetimit të mësipërm Gjykata arrinë konkluzionin se pretendimet e subjektit të interesuar lidhur me themelin e titullit ekzekutiv nuk mund të merren në shqyrtim prej saj.

*A. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës*

16. Kërkuesi pretendon se, që prej marrjes formë të prerë të vendimit nr. 297, datë 14.12.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili ka lënë në fuqi vendimin e KSHC-së, dhe lëshimit të urdhrimit të ekzekutimit nr. 137, datë 18.12.2008, ka kaluar një kohë e gjatë dhe e pajustificuar për ekzekutimin e vendimit.

17. Gjykata ka vlerësuar se ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, por detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre. Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës është konsideruar si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht, sepse vetëm pas realizimit të saj mund të konsiderohet se individit e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 21, datë 3.6.2011; nr. 6, datë 4.3.2010; nr. 6, datë 6.3.2009; nr. 1, datë 19.1.2009; nr. 43, datë 19.12.2007*).

18. Gjykata rikonfirmon qëndrimin se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces. Kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuesit, si dhe sjelljen e autoriteteve përkatëse (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 21, datë 3.6.2011; nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 9, datë 1.4.2009*).

19. Në lidhje me kompleksitetin e çështjes, Gjykata ka ritheksuar vazhdimisht se, për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shpresore (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 50, datë 22.11.2011; nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 9, datë 1.4.2009*).



20. Çështja në shqyrtim ka për objekt mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, për sa i përket kthimit në punë dhe pagimit të pjesës së mbetur të pagës. Duke iu referuar parashtimeve dhe materialeve shkresore, Gjykata vlerëson se, çështja konkrete nuk paraqet kompleksitet nga pikëpamja faktike ose ligjore, çka mund të justifikonte vonesat apo sjelljen mosvepruese të subjekteve të interesuara, Këshillit të Ministrave dhe zyrës së përbarimit Tiranë. Për pasojë, vlerësimi i sjelljes së këtyre autoriteteve publike dhe kërkuesit është me rëndësi në këtë kontekst.

21. Gjykata, në jurisprudencën e saj është shprehur se vlerësimi i sjelljes dhe i interesit të kërkuesit është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve, duke nënvizuar se përdorimi nga ana e kërkuesit i të gjitha procedurave të parashikuara nga e drejta e brendshme, me qëllim sigurimin e mbrojtjes, nuk mund të përdoret si argument kundër tij (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 50, datë 22.11.2011; nr. 14, datë 15.4.2010*). Në çështjen objekt shqyrtimi Gjykata konstaton se, kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion të tij për rivendosjen e së drejtës së cenuar. Nga tërësia e fakteve dhe rrethanave, në vlerësimin e Gjykatës nuk rezulton që sjelljet e kërkuesit të jenë bërë shkak për mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë.

22. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave (KM), në cilësinë e debitorit, ka kryer disa veprime që të krijojnë bindjen se ka vullnetin për të ekzekutuar vendimin gjyqësor të formës së prerë. Debitori në datën 20.1.2009 ka kaluar në llogarinë e përbaruesit, për llogari të kërkuesit, detyrimin financiar për deri në atë datë, që konsistonte në: a) pagesën e pagës për një vit nga momenti i largimit deri në datën 2.3.2007, pasi Këshilli i Ministrave e ka konsideruar kërkuesin në listë pritjeje; dhe b) pagesën e 22 pagave mujore të kategorisë II-b, duke filluar që nga data 2.3.2007 deri në datën 2.1.2009. Pjesa tjetër e detyrimit financiar, duke filluar që nga data 1.2.2009 e në vazhdim, si dhe rikthimi në pozicionin e mëparshëm, ende nuk janë ekzekutuar. Për të justifikuar këtë mosveprim debitori ka paraqitur dy argumente: 1. mungesën e fondeve; dhe 2. pamundësinë objektive të rikthimit në pozicionin e mëparshëm për arsye se vendi i punës për ushtrimin e funksionit përkatës nuk ekziston më që nga viti 2005.

23. Gjykata ka theksuar edhe më parë se autoritetet shtetërore nuk mund të justifikohen me mungesën e fondeve për të mos respektuar një detyrim financiar që vjen nga një vendim gjyqësor (*shih vendimin nr. 16, datë 4.5.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe GJEDNJ-ja në çështjen Qufaj kundër Shqipërisë, datë 18 nëntor 2004. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata çmon se pala debitore i kishte të gjitha mundësitë që gjatë periudhës, duke filluar nga dita e marrjes formë të prerë të vendimit e deri në ekzekutimin e plotë të tij, t'i paguante kërkuesit shumën që i detyrohej sipas titullit ekzekutiv. Debitori, me marrjen dijeni të vendimit të formës së prerë, duhet të merrte masat për ekzekutimin e plotë të detyrimeve që i ishin ngarkuar në favor të kërkuesit/kreditor.

24. Për sa i përket rikthimit në punë, KM-ja ka pretenduar pazbatueshmërinë e vendimit për këtë pjesë, duke argumentuar se rikthimi në pozicionin e mëparshëm është i pamundur për shkak të ristrukturimit të Departamentit dhe ndryshimit të kriterëve të punës për pozicionin përkatës. Gjykata, në jurisprudencën e saj, është shprehur se i takon debitorit të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme për këtë rast me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit (*shih vendimin nr. 2, datë 1.2.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Për më tepër, Gjykata vë në dukje se KM-ja, megjithëse pretendon pamundësinë objektive të zbatimit të vendimit për pjesën e rikthimit në punë, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim konkret për të vënë në dijeni Zyrën e Përbarimit Tiranë për këtë fakt. Gjatë seancës gjyqësore u evidentua se nuk rezulton asnjë lloj korrespondence zyrtare ndërmjet KM-së dhe Zyrës së Përbarimit Tiranë në lidhje me këtë çështje.

25. Nisur nga arsyetimi i mësipërm, Gjykata vlerëson se argumentet e paraqitura nga KM-ja, lidhur me arsyet se përse nuk është ekzekutuar vendimi gjyqësor i formës së prerë, janë të pambështetura.

26. Gjykata ka nënvizuar vazhdimisht se në fazën e ekzekutimit të vendimeve marrin pjesë aktivisht jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Roli i këtyre organeve bëhet vendimtar, kur debitori refuzon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin e tij karshi kreditorit. Në raste të tilla procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe mënyrën e kryerjes së veprimeve konkrete të organeve përgjegjëse, të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 6, datë 4.3.2010*).

27. Zyra e Përmbarrimit Tiranë, pas kërkesës së paraqitur nga kërkuesi, fillimisht i është drejtuar debitorit (KM-së) me lajmërim për ekzekutim vullnetar (shkresa nr.734 prot., datë 16.1.2009) e më pas me vendim për ekzekutim të detyruar (shkresa nr. 1662 prot., 5.2.2009). Pas shlyerjes së pjesshme të detyrimit financiar nga ana e KM-së, Zyra e Përmbarrimit Tiranë i është drejtuar sërish KM-së me dy kërkesa për ekzekutim të titullit ekzekutiv, me objekt pagesën e detyrimit financiar, duke filluar nga data 1.2.2009 deri në ekzekutimin e vendimit dhe rikthimin në punë, që mbajnë përkatësisht datat 4.6.2009 dhe 19.5.2010, të cilave debitori nuk u është përgjigjur. Edhe shoqëria përmbarrimore private “EPSA” sh.p.k., e kontraktuar nga kërkuesi i ka dërguar debitorit disa shkresa për ekzekutimin e vendimit gjyqësor (nr.731 prot. datë 31.1.2011; nr. 1316 prot, datë 21.2.2011 dhe nr. 1697, datë 10.3.2011). Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se përmbarruesi gjyqësor, si subjekt procedural në fushën e ekzekutimit, është i pajisur me të gjitha mjetet procedurale që mundësojnë ekzekutimin e titullit ekzekutiv (*shih vendimin nr.21, datë 3.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Në vlerësimin e Gjykatës, të gjitha subjektet, qofshin këto private apo publike, duhet të përgjigjen njëllëj përballë detyrimit për zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë (*shih vendimin nr. 21, datë 3.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Lidhur me sjelljen e autoriteteve përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve, Gjykata vlerëson se përmbarruesi gjyqësor nuk ka pasur asnjë pengesë ligjore për të ekzekutuar vendimin gjyqësor të formës së prerë.

29. Gjykata vëren se “urdhri ekzekutiv” i lëshuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë nr. 297, datë 14.12.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë, mban datën 18.12.2008. Kanë kaluar më shumë se dy vjet nga data që ka dalë ky urdhër ekzekutimi dhe ai ende nuk është zbatuar tërësisht.

30. Për sa më sipër, Gjykata nuk gjen arsye të bazuara që kanë çuar në mosrealizimin e të drejtës së kërkuesit për një proces të rregullt ligjor. Gjykata vlerëson se në çështjen në shqyrtim, përmbarruesi gjyqësor dhe KM-ja i kishin të gjitha mundësitë që të ekzekutonin vendimin gjyqësor të formës së prerë.

31. Si përfundim, në çështjen objekt shqyrtimi, Gjykata vlerëson se mosekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë ka sjellë cenimin e të drejtës së kërkuesit për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i KEDNJ-së.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/g të Kushtetutës, si dhe në nenin 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,





**VENDOSI:**

- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 297, datë 14.12.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Petrit Ploçi, Sokol Berberi, Altina Xhoxhaj, Admir Thanza

**VENDIM**

**Nr. 11, datë 2.3.2012**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Ploçi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Admir Thanza	Anëtar i “ “
Altina Xhoxhaj	Anëtare e “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “

me sekretare Enina Mullaj, në datën 20.10.2011 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh çështjen nr. 35/11 akti, që i përket:

**KËRKUES:** Ndok Gjini

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:** Zyra e Përmbartimit Lezhë; Bardhok Jaku, Taze Jaku

**OBJEKTI:** Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 484, datë 20.9.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Shfuqizimi i vendimit nr. 102, datë 18.3.2011 të Gjykatës së Lartë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 131/f, 134/g dhe 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberin dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**I**

1. Kërkuesi është pronar i një trualli prej 1350 m<sup>2</sup>, të ndodhur në fshatin Tresh Lezhë, për të cilin zotëron certifikatën e pronësisë me nr. 5139, datë 29.5.2006. Gjykata e Rrethit Gjyqësor

Lezhë, pas padisë së paraqitur nga kërkuesi me objekt “Kthim sendi”, ka vendosur, me vendimin nr. 484, datë 20.9.2007, detyrimin e të paditurve të lirojnë dhe të dorëzojnë sipërfaqen e tokës prej 300 m<sup>2</sup>, pronar i së cilës është kërkuesi.

2. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. 174, datë 2.4.2008. Në datën 21.5.2008, me vendimin nr. 122, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për zbatimin e vendimit civil të formës së prerë nr. 484, datë 20.9.2007.

3. Zyra e Përmbarrimit Lezhë, në datën 5.6.2009, ka shkuar në vend dhe ka kryer veprimet përmbarrimore përkatëse. Sipas procesverbalit të përpiluar për kryerjen e veprimeve përmbarrimore, Zyra e Përmbarrimit Lezhë ka nxjerrë vendimin nr. 196/ç prot., datë 8.6.2009, për pushimin e urdhrit të ekzekutimit, duke e konsideruar vendimin gjyqësor të ekzekutuar plotësisht.

4. Kërkuesi, duke mos qenë dakord me veprimet e përmbarruesit gjyqësor, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë me padi me objekt “Kundërshtimin e veprimeve të përmbarruesit gjyqësor”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. 843, datë 29.7.2009, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të pushimit të ekzekutimit nr. 196/ç prot. datë 8.6.2009 dhe urdhërimin e Zyrës së Përmbarrimit Lezhë për vazhdimin e procedurave të ekzekutimit.

5. Mbi ankimin e palëve, Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 609, datë 13.12.2010, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit civil nr. 843, datë 29.7.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

6. Kundër këtij vendimi të Gjykatës së Apelit Shkodër ka paraqitur rekurs pala e paditur dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 102, datë 13.03.2011 ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 609, datë 13.12.2010 të Gjykatës së Apelit Shkodër.

7. *Kërkuesi* i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (në vijim “Gjykata”), duke pretenduar se:

7.1 i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor për arsye të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;

7.2 vendimi i Gjykatës së Lartë ka cenuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

8. *Subjekti i interesuar*, Zyra e Përmbarrimit Lezhë, për të kundërshtuar pretendimet e kërkuesit në lidhje me afatin e arsyeshem, ka paraqitur me shkrim parashtrimet mbi veprimet përmbarrimore të kryera për ekzekutimin e vendimit gjyqësor nr. 484, datë 20.9.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Sipas kësaj zyre, veprimet përmbarrimore janë kryer në përputhje me legjislacionin përmbarrimor në fuqi dhe nuk janë bërë shkak për cenimin e afatit të arsyeshem, për sa i përket ekzekutimit të vendimit gjyqësor.

9. *Subjektet e interesuara*, Bardhok Jaku dhe Taze Jaku kanë paraqitur me shkrim parashtrimet e tyre dhe kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës duke pretenduar se: a) kërkesa nuk përmban asnjë element që do të përbënte shkelje kushtetuese; b) pretendimet e kërkuesit janë të pambështetura; c) vendimi i Gjykatës së Lartë për pezullimin e ekzekutimit është i drejtë.

## II

*A. Për pretendimin e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshem, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës*

10. Kërkuesi pretendon se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor për arsye të mosekzekutimit të vendimit të formës së prerë nr. 484, datë 20.9.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Sipas kërkuesit, që prej marrjes formë të prerë të këtij vendimi dhe lëshimit të urdhrit të ekzekutimit nr. 122, datë 13.5.2008, ka kaluar një kohë e gjatë, e cila është e pajustificuar për ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

11. Gjykata është shprehur edhe më parë se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshem i një vendimi të formës së prerë të gjykatës është pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të Kushtetutës dhe të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) (*shih*



*vendimin nr. 6, datë 7.3.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Në këtë fazë duhet të marrin pjesë aktivisht jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë (*shih vendimet nr. 6, datë 6.3.2009; nr. 1, datë 19.1.2009; nr. 43, datë 19.12.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura Gjykata konstaton se kërkuesi është pronar i sipërfaqes së tokës prej 1350 m<sup>2</sup>, të ndodhur në fshatin Tresh Lezhë, sipas certifikatës së pronësisë me nr. 5139, datë 29.5.2006 të lëshuar nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZRRPP), Lezhë. Vendimi nr. 484, datë 20.9.2007 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, objekt i këtij shqyrtimi, ka detyruar të paditurit të lirojnë dhe të dorëzojnë sipërfaqen e tokës prej 300 m<sup>2</sup>, pronar i së cilës është kërkuesi. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 174, datë 2.4.2008 dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, pasi ka konstatuar se vendimi nr. 484, datë 20.09.2007, ka marrë formë të prerë në bazë të dispozitave procedurale civile përkatëse, ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për zbatimin e tij.

13. Zyra e Përmbarrimit Lezhë ka filluar procedurat përmbarrimore për zbatimin e vendimit gjyqësor nr. 484, datë 20.9.2007. Sipas parashtimeve të paraqitura, fillimisht kjo zyrë i ka dërguar palës debitore, në datën 31.3.2009, lajmërim për ekzekutim vullnetar dhe më pas në datën 23.4.2009 ka nxjerrë vendim për kalim në ekzekutim të detyrueshëm. Në datën 5.6.2009 zyra e përmbarrimit, Lezhë ka kryer në vend identifikimin dhe përcaktimin e sipërfaqes 300 m<sup>2</sup>, objekt ekzekutimi, dhe ka liruar në favor të kreditorit një pjesë të kësaj sipërfaqeje, duke mos ekzekutuar vendimin gjyqësor për pjesën tjetër të sipërfaqes. Sipas procesverbalit të mbajtur mbi këto veprime përmbarrimore, Zyra e Përmbarrimit Lezhë, ka nxjerrë vendimin nr. 196/ç prot., datë 8.6.2009, për pushimin e urdhrin të ekzekutimit, duke e konsideruar vendimin gjyqësor, objekt shqyrtimi, të ekzekutuar plotësisht.

14. Kërkuesi, ka kundërshtuar veprimet e përmbarruesit gjyqësor, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, e cila pasi ka vlerësuar se veprimet përmbarrimore nuk janë kryer në përputhje me pjesën urdhëruese të vendimit të formës së prerë nr. 484, datë 20.9.2007, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të pushimit të ekzekutimit nr. 196/ç prot. datë 8.6.2009 dhe urdhërimin e zyrës së përmbarrimit Lezhë për vazhdimin e procedurave të ekzekutimit deri në ekzekutimin e plotë të vendimit.

15. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 609, datë 13.12.2010, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit civil nr. 843, datë 29.7.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Pas ushtrimit të rekursit ndaj këtij vendimi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 102, datë 13.3.2011 ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 609, datë 13.12.2010 të Gjykatës së Apelit Shkodër.

16. Mbi bazën e dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Kancelaria e Gjykatës së Lartë (shkresa nr. 229 prot. datë 27.9.2011) rezulton se në datën 19.05.2011 është regjistruar në Gjykatën e Lartë çështja civile me objekt “kundërshtim i veprimeve të përmbarruesit gjyqësor” ku palë ndërgjyqëse janë kërkuesi dhe subjektet e interesuara në çështjen objekt i këtij shqyrtimi kushtetues. Kancelaria e Gjykatës së Lartë bën me dije Gjykatën se kjo çështje ndodhet në fazë studimi dhe në pritje për të kaluar për shqyrtim në Dhomë Këshillimi.

17. Nisur nga fakti i mësipërm, Gjykata konstaton se çështja konkrete është ende në shqyrtim në Gjykatën e Lartë dhe për pasojë vlerëson se nuk jemi në kushtet e cenimit të standardit të afatit të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Në lidhje me veprimet e zyrës së

përmbartimit Lezhë, si organ shtetëror i ngarkuar me përgjegjësinë për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, Gjykata çmon se kjo zyrë ka kryer të gjitha veprimet që i lejon ligji, për të ekzekutuar vendimin e formës së prerë të gjykatës, në përputhje me dispozitat procedurale të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

18. Si përfundim, duke pasur parasysh faktin se palët janë ende në proces dhe veprimet konkrete të institucioneve shtetërore kanë qenë në përputhje me legjislacionin në fuqi, Gjykata konkludon se nuk është cenuar parimi kushtetues i afatit të arsyeshëm, në lidhje me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuarit është i pabazuar.

*B. Për pretendimin e mosarsyetimit të vendimit gjyqësor*

19. Kërkuari pretendon, gjithashtu, se vendimi nr. 102, datë 13.03.2011 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ka cenuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, pasi dispozitivi i vendimit nuk përputhet me arsyetimin e tij.

20. Gjykata, në jurisprudencën e saj ka rikonfirmuar qëndrimin se arsjetimi i vendimeve gjyqësore është një element i së drejtës për një proces të rregull ligjor, në kuptim të neneve 42 dhe 142/1 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së.

21. Megjithatë, duke pasur parasysh se çështja është ende në shqyrtim në Gjykatën e Lartë, Gjykata konstaton se, vendimi i Gjykatës së Lartë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, objekt shqyrtimi, është një vendim i ndërmjetëm, jopërfundimtar. Kërkuarit do t'i jepet një zgjidhje përfundimtare vetëm pasi çështja të shqyrtohet nga Gjykata e Lartë dhe kjo e fundit të shprehet me një vendim përfundimtar.

22. Në këto rrethana, duke qenë se procesi është ende i papërfunduar, Gjykata çmon se edhe ky pretendim i kërkuarit është i pambështetur.

23. Përfundimisht, për sa më sipër, në çështjen objekt shqyrtimi, Gjykata nuk gjen elemente të një procesi të parregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

**PËR KËTO ARSYE,**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f e 134/g të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

**VENDOSI:**

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar) Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Admir Thanza, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj

Anëtarë kundër: Petrit Pllaçi, Sokol Berberi



## MENDIM PAKICE

Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën, për sa i takon rrëzimit të kërkesës së paraqitur nga kërkuesi, e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim pakice. Shumica në këtë çështje, pretendimin e kërkuesit për mosekzekutim të vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, e ka çmuar të pabazuar, me argumentin se çështja është ende në shqyrtim në Gjykatën e Lartë dhe për pasojë nuk është cenuar parimi kushtetues i afatit të arsyeshëm, në lidhje me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Në rastin konkret, pakica e konsideron të rëndësishme të ritheksojë parimet kushtetuese që rregullojnë ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës prerë brenda një afati të arsyeshëm. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) është shprehur se nenet 42, 142/3 të Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pa kufi për realizimin e saj. Ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi të formës së prerë të gjykatës është pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të KEDNJ-së (*shih vendimet nr. 6, datë 7.3.2011; nr. 6, datë 6.3.2009; nr. 27, datë 20.6.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces. Siç është pohuar dhe nga shumica, ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (*shih vendimin nr. 6, datë 6.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të prekë thelbin e së drejtës (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 11, datë 12.4.2011; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 6, datë 4.3.2010; nr. 43, datë 19.12.2007*).

Duke iu referuar standardeve të mësipërme, pakica, në ndryshim nga shumica, vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me cenim të afatit të arsyeshëm në lidhje me ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, mbi bazën e arsyesimit që shtjellohet në vijim. Pakica rikonfirmon qëndrimin se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuesit, si dhe sjelljen e autoriteteve përkatëse (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 12, datë 15.4.2011; nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 9, datë 1.4.2009*).

Nga rrethanat e çështjes konkrete rezulton se procedura gjyqësore ka filluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, e cila me vendimin nr. 484, datë 20.9.2007, ka vendosur detyrimin e subjekteve të interesuara, Bardhok e Taze Jaku, të lirojnë dhe të dorëzojnë sipërfaqen e tokës prej 300 m<sup>2</sup>, pronar i së cilës është kërkuesi. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit dhe, në përputhje me dispozitat procedurale civile, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për zbatimin e vendimit civil të formës së prerë nr. 484, datë 20.9.2007. Zyra e përmbarrimit Lezhë në datën 5.6.2009 ka kryer veprimet përmbarrimore përkatëse dhe pasi ka shkuar në vend, mbi bazën e procesverbalit të mbajtur, ka nxjerrë vendimin nr. 196/ç prot. datë 8.6.2009 për pushimin e ekzekutimit, pasi sipas saj, vendimi ishte ekzekutuar plotësisht dhe debitori kishte plotësuar detyrimin ndaj kreditorit. Kërkuesi ka kundërshtuar veprimet e përmbarruesit gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë e cila, me vendimin nr. 843, datë 29.7.2009 ka vendosur shfuqizimin e vendimit të pushimit të ekzekutimit nr. 196/ç prot., datë 8.6.2009, dhe urdhërimin e

Zyrës së Përmbarrimit Lezhë për vazhdimin e procedurave të ekzekutimit. Më tej, Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 609, datë 13.12.2010, ka vendosur lënien në fuqi të këtij vendimi ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër.

Nisur nga faktet më sipër, pakica vëren se, që nga nxjerrja e urdhrit të ekzekutimit e deri në momentin e bërjes së kërkesës përpara kësaj gjykate, kanë kaluar rreth 3 (tre) vjet dhe ky urdhër ende nuk është zbatuar plotësisht. Mbi bazën e certifikatës së pronësisë nr. 5141, datë 29.5.2006, kërkuesi është pronar i truallit mbi të cilin disponon vendimi gjyqësor i formës së prerë nr. 484, datë 20.9.2007. Si pronar i ligjshëm ai ende nuk e ka rivendosur në vend të drejtën e pronës, që është cenuar si pasojë e mosekzekutimit tërësor të një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

Lidhur me kompleksitetin e çështjes, Gjykata ka theksuar se për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara, vëllimin e provave shkresore (shih vendimin nr. 21, datë 3.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese). Çështja objekt gjykimi, në vlerësimin e pakicës, nuk paraqet kompleksitet nga pikëpamja faktike ose ligjore, çka mund të justifikonte vonesat apo sjelljen mosvepruese të organeve të ngarkuara nga ligji për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Nga certifikata e pronësisë dhe vendimet gjyqësore, është e qartë se sipërfaqja e tokës, të cilën subjektet e interesuara e përdorin në mënyrë të jashtëligjshme, është në pronësi të kërkuesit.

Për sa i përket sjelljes (veprimeve) të kërkuesit, rezulton se ai ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion për rivendosjen e së drejtës së cenuar. Pakica çmon se sjellja e kërkuesit nuk është bërë shkak për tejkalimin e afatit të arsyeshëm për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë. Kërkuesi i ka ushtruar të gjitha mjetet ankimore të njohura nga ligji, në përputhje me afatet e përcaktuara nga dispozitat procedurale civile. Për më tepër, nga dokumentet e shqyrtuara, vërehet se sjellja e kërkuesit ka qenë aktive, duke iu drejtuar institucioneve përkatëse shtetërore për rivendosjen e së drejtës së tij të fituar nga vendimi gjyqësor i formës së prerë.

Në vijim, pakica vlerëson nëse autoritetet shtetërore përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, në rastin konkret, përmbarruesi gjyqësor ka marrë ose jo masat e nevojshme për zbatimin e urdhrit të ekzekutimit, në përputhje me vendimin gjyqësor të formës së prerë. Zyra e Përmbarrimit Lezhë, në datën 31.3.2009 ka dërguar fillimisht njoftim për ekzekutim vullnetar dhe në datën 23.4.2009 ka marrë vendim për ekzekutim të detyrueshëm. Në datën 5.6.2009, Zyra e Përmbarrimit ka kryer veprimet përmbarrimore përkatëse për zbatimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Mbi bazën e procesverbalit të mbajtur në vend, kjo zyrë ka nxjerrë vendimin nr. 196/ç prot. datë 8.6.2009, për pushimin e urdhrit të ekzekutimit, pasi e ka konsideruar vendimin gjyqësor të ekzekutuar plotësisht. Megjithatë, duke iu referuar vendimeve gjyqësore të bashkëlidhura në dosje, rezulton se urdhri i ekzekutimit është zbatuar pjesërisht dhe jo plotësisht; subjektet e interesuara nuk e kanë liru banesën e ndërtuar në mënyrë të paligjshme në pronën e kërkuesit. Zyra e Përmbarrimit, edhe pse me vendimin nr. 843, datë 29.7.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, është urdhëruar të vazhdojë procedurën e ekzekutimit, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim përmbarrimor deri në nxjerrjen e vendimit nr. 102, datë 18.3.2011 të Gjykatës së Lartë për pezullimin e ekzekutimit. Vetëm pas këtij vendimi, Zyra e Përmbarrimit ka nxjerrë vendimin e pezullimit nr. 593/ç, datë 31.3.2011. Pavarësisht vendimit të ndërmjetëm të Gjykatës së Lartë, sipas së cilit është pezulluar ekzekutimi, pakica vlerëson se kjo nuk përbën arsye të justifikuar për mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë nr. 484, datë 20.9.2007. Duke pasur parasysh se veprimet përmbarrimore për ekzekutimin e këtij vendimi kanë filluar në datën 27.3.2009, pakica konstaton se afati i ekzekutimit është zgjatur në mënyrë të paarsyeshme nga mosveprimet e Zyrës së Përmbarrimit. Këto mosveprime janë bërë shkak për mosekzekutimin tërësor të vendimit gjyqësor të formës së prerë.



Gjithashtu, pakica vë në dukje se, asnjë instancë gjyqësore nuk ka shfuqizuar ose ndryshuar vendimin nr. 484, datë 20.9.2007, objekt shqyrtimi. Argumenti i përdorur nga shumica se nuk jemi në kushtet e cenimit të parimit kushtetues të afatit të arsyeshëm, në lidhje me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, për arsye se palët janë ende në proces në Gjykatën e Lartë, nuk është i mbështetur. Pakica vëren se subjektet e interesuara kanë kërkuar në Gjykatën e Lartë pezullimin e vendimit nr. 609, datë 13.12.2010 të Gjykatës së Apelit Shkodër, supra, dhe nuk kanë kundërshtuar vendimin e formës së prerë nr. 484, datë 20.9.2007, i cili është objekt i këtij gjykimi, për sa i përket ekzekutimit brenda një afati të arsyeshëm.

Nisur nga argumentet e mësipërme, pakica vlerëson se pretendimi i kërkuarit, për mosekzekutim të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, është i bazuar dhe duhej të pranohet nga Gjykata.

Anëtarë: Sokol Berberi, Petrit Ploçi

**VENDIM**  
**Nr.12, datë 5.3.2012**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i	Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar	i	“ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“ “
Vitore Tusha	Anëtare	e	“ “
Sokol Berberi	Anëtar	i	“ “
Admir Thanza	Anëtar	i	“ “
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e	“ “
Petrit Ploçi	Anëtar	i	“ “

me sekretare Brunilda Bara, në datën 2.6.2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 12/2 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** Adelina Koliqi, në mungesë.

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:** Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë (KRRTRSH), në mungesë;

Ministria e Drejtësisë, Avokatura e Përgjithshme e Shtetit, përfaqësuar nga Enkeledi Hajro dhe Abaz Deda.

**OBJEKTI:** Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42/2, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe nenet 6 e 13 të KEDNJ-së.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Petrit Ploçi; përfaqësuesin e subjekteve të interesuara që kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Kërkuesja, në datën 2.10.2006, ka ngritur padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke kërkuar anulimin e vendimit nr.2, datë 26.5.2006 të KRTRSH-së. Kjo gjykatë ka filluar shqyrtimin e kësaj padie më datë 6.12.2006 dhe, deri në kohën e paraqitjes së kërkesës në Gjykatën Kushtetuese, ende nuk ka dalë me një vendim themeli në lidhje me pretendimin e kërkueses, duke e shpallur të bazuar ose jo atë.

*Kërkuesja*, në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, kërkon konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e moszhvillimit të gjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm (neni 42/2 i Kushtetutës). Ajo pretendon se, pavarësisht se ende nuk ka një vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me gjykimin e iniciuar prej saj, në bazë të neneve 131/f dhe 134/g të Kushtetutës, si individ legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, për shkak se legjislacioni nuk parashikon gjatë zhvillimit të procesit të gjykimit nga gjykatat e zakonshme, mjete juridike për mbrojtjen e të drejtës kushtetuese për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm. Kërkuesja, lidhur me pretendimin e saj për mosgjykimin e çështjes së saj brenda një afati të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës, mbështetet në kriteret e përcaktuara nga GJEDNJ-ja të reflektuara më pas edhe në praktikën e Gjykatës Kushtetuese. Sipas këtyre kriterëve, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuesit, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që passjell për kërkuesin kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit.

Sipas kërkueses, çështja e iniciuar prej saj, objekt i gjykimit të zakonshëm, nuk është çështje komplekse, pasi faktet dhe natyra e çështjes u përcaktuan që në fillim të gjykimit nëpërmjet parashtrimit të bërë prej palëve ndërgjyqëse, gjatë gjykimit të zhvilluar nuk ka rezultuar të ketë palë të tjera që të pretendojnë të drejta mbi objektin e gjykimit, legjislacioni i zbatueshëm në rastin në shqyrtim është i qartë dhe nuk paraqet ndonjë problem mbi përputhshmërinë e tij me Kushtetutën.

Lidhur me sjelljen e saj (kërkueses), kjo e fundit shton se ajo, nga ana e saj, referuar kronologjisë së seancave, nuk ka shkakuar vonesë për zhvillimin e gjykimit. Përkundrazi, disponueshmëria e saj e vazhdueshme tregon qartazi përpjekjet e saj për të përshpejtuar procesin gjyqësor.

Për sa i përket sjelljes së autoriteteve publike, kërkuesja pretendon se gjykata e zakonshme nuk është kujdesur që procesi gjyqësor të zhvillohet në mënyrë të rregullt duke siguruar progresin e gjykimit me shpejtësi të mjaftueshme, se seancat gjyqësore më së shumti janë shtyrë për shkak të mosnjohjes prej palëve munguese të një aktekspertimi topografik, i cili nuk ka të bëjë aspak me objektin e padisë, që përkundrazi në thelb i përket vlerësimit dhe gjykimit të ligjshmërisë së aktit administrativ, dhe jo sqarimit dhe konstatimit të faktit nëse ka mbivendosje sipërfaqesh.

*Subjektet e interesuara, të përfaqësuar nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, kanë pretenduar se kërkuesja nuk i ka shtruar mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtës së saj, sepse ajo nuk ka një vendim gjyqësor përfundimtar që të cenojë të drejtat e saj kushtetuese (neni 131/f i Kushtetutës); se kërkuesja mund ta realizonte të drejtën e saj duke iu drejtuar gjykatës me padi, në mbështetje të ligjit nr. 8510, datë 15.07.1999 "Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore" ose duke kërkuar zbatimin e drejtpërdrejtë të Kushtetutës, dhe konkretisht të neneve 15/2 dhe 44 të Kushtetutës.*

Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, në vlerësimin e *meritës* së pretendimit të kërkueses, duke u mbështetur në *kriteret* e përcaktuara nga GJEDNJ-ja, lidhur me arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor, ka theksuar faktin që, në çështjen në shqyrtim, përveç palës paditëse dhe të





paditur ka pasur edhe palë të treta, institucione shtetërore qendrore dhe lokale, si dhe faktin se gjatë kohës që çështja ishte në gjykim kanë ndodhur disa amendime normative që kanë ndikuar në kompleksitetin e çështjes. Po kështu, sipas Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, kërkuësja, vetë apo nëpërmjet avokatëve të saj mbrojtës, ka ndikuar në zvarritjen e procesit gjyqësor. Ndërsa lidhur me sjelljen e autoriteteve, sipas Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, institucioneve shtetërore nuk mund t'i atribuohet zvarritja e procesit. Për sa i përket *interesit që i është* cenuar kërkuëses, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit është shprehur se kërkuëses nuk i ka ardhur ndonjë dëm apo pasojë e padëshiruar nga veprimtaria e autoriteteve shtetërore.

## II. Mbi pranueshmërinë për shqyrtim të kërkesës

Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, si përfaqësues i subjekteve të interesuara, ka pretenduar se kërkuësja nuk ka shteruar mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtës së saj, sepse: a) nuk ka një vendim gjyqësor përfundimtar që të cenojë të drejtat e saj kushtetuese (neni 131/f i Kushtetutës); b) se kërkuësja mund ta realizonte të drejtën për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm, duke iu drejtuar gjykatës me padi në mbështetje të ligjit nr. 8510 të sipërpërmendur, ose duke kërkuar zbatimin e drejtpërdrejtë të Kushtetutës (neneve 15/2 dhe 44); c) se kërkuësja mund të ankohej për tejzgjatjen e procesit duke ngritur padi në gjykatë në mbështetje të ligjit nr. 8510 datë 15.7.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”; d) se për rivendosjen e të drejtës kushtetuese për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm, kërkuësja mund të invokonte edhe nenin 467/a të Kodit të Procedurës Civile.

Lidhur me këtë pretendim Gjykata Kushtetuese vlerëson se, sipas nenit 131/f të Kushtetutës, rregulli i shterimit të mjeteve juridike, vendos një detyrim për individët që përpara se të ankohen pranë kësaj Gjykate për shkeljen e të drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor (neni 42 i Kushtetutës), duhet të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Në këtë drejtim, duke pasur parasysh se, në bazë të nenit 17 të Kushtetutës, *kufizimet e të drejtave dhe lirive në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut*, dhe se sipas nenit 5 të ligjit nr.8137, datë 31.7.1996 “Për Ratifikimin e Konventës Evropiane Për Mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut”, *...nëjthet ... juridiksioni i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për interpretimin dhe zbatimin e Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ...*”, Gjykata Kushtetuese vlerëson se, lidhur me interpretimin e rregullit të shterimit të mjeteve juridike (nenin 131/f të Kushtetutës), si dhe të së drejtës individuale për të pasur një mjet juridik efektiv (neni 13 i Konventës), kjo Gjykatë duhet t'i referohet jurisprudencës së GJEDNJ-së, lidhur me nenet 13 e 35 të KEDNJ-së.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se detyrimi i ankuesve për shterimin e mjeteve juridike, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, kërkon që këto mjete duhet të jenë të pranishëm në sistemin juridik të vendit, si dhe të përmbushin kriteret që kërkon KEDNJ-ja (neni 13).

Sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, efekti i nenit 13 të Konventës kërkon parashikimin e një mjeti juridik të brendshëm për të trajtuar themelin e një “ankese të pranueshme” në bazë të Konventës dhe për të dhënë një kompensim të përshtatshëm (*shih Gjyli kundër Shqipërisë, aplikimi nr.32907/07, par.53*). Fushëveprimi i obligimit të Shteteve Anëtare, në bazë të nenit 13, varion në varësi të natyrës së ankesës së aplikantit (*shih Kudla v. Poland, datë 26.10.2000, apl. Nr.30210/96, par. 157*). Megjithatë, ekzistenca e këtyre mjeteve juridike duhet të jetë mjaftueshmërisht e qartë, jo vetëm në teori por edhe në praktikë, në të kundërtën atyre do t'u mungojë kushti i aksesit dhe i efektivitetit (*shih vendimin e pranueshmërisë në çështjen Lehtinen v. Finland, aplikimi nr. 39076/97, par.5*). Gjithashtu, “autoriteti” të cilit i referohet neni 13 i Konventës nuk duhet domosdoshmërisht të jetë një autoritet gjyqësor; por në qoftë se ky autoritet nuk është i tillë, pushtetet/kompetencat e tij dhe garancitë që ai ofron, janë të rëndësishme për të përcaktuar nëse ky autoritet përbën një mjet

efektiv. Gjithashtu edhe sikur një mjet i vetëm të mos i plotësojë kërkesat e nenit 13, tërësia e mjeteve të ofruara në bazë të së drejtës së brendshme mund t'i plotësojë (*shih Silver and Others v. UK, apl. nr.5947/73, par. 113*).

Gjykata Kushtetuese, lidhur me pretendimin për shkeljen e të drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshem, duhet të shqyrtojë nëse ka pasur mjete të cilave pala kërkuese duhet t'u drejtohej.

Në këtë drejtim, sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, në kuptim të nenit 13 të Konventës, mjetet në dispozicion të një ndërgjyqësi për të parashtruar një ankesë për zgjatjen e procesit janë "efektive", në qoftë se ato "parandalojnë shkeljen e pretenduar apo pengojnë vazhdimin e saj, apo ofrojnë një riparim të përshtatshëm për çdo shkelje që tashmë ka ndodhur". Siç shprehet GJEDNJ-ja, neni 13 i KEDNJ-së ofron një alternativë: një mjet është "efektiv" në qoftë se mund të përdoret ose për të përshpejtuar dhënien e një vendimi nga gjykatat që gjykojnë një çështje, ose për t'i ofruar ndërgjyqësit një riparim të përshtatshëm për vonesat që tashmë kanë ndodhur. Megjithatë, thekson GJEDNJ-ja, zgjidhja më e mirë është padyshim, parandalimi. Kur një sistem gjyqësor ka mangësi për sa i përket kërkesës në nenin 6/1 të Konventës – për një afat të arsyeshem, një mjet i dizenuar për të përshpejtuar procesin, me qëllim parandalimin e bërjes së këtij procesi të tejzgjatur, është zgjidhja më efektive. Një mjet i tillë ofron një avantazh të pamohueshem në krahasim me një mjet që ofron vetëm kompensim, përderisa ai parandalon gjithashtu shkeljet e mëpasshme për të njëjtat procese dhe jo thjesht riparim shkeljen *a posteriori*, siç bën një mjet kompensues. Disa shtete kanë zgjedhur kombinimin e dy lloj mjetesh, njëri i dizenuar për të përshpejtuar procesin dhe tjetri për të ofruar kompensim (*shih Scordino v. Italy, nr.1, apl. Nr.36813/97, par. 183, 186, i cituar në vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Gjonboçari kundër Shqipërisë, aplikimi nr.10508/02, par.75 e 76*).

Po kështu, Gjykata Kushtetuese thekson se, kur shtrohet çështja nëse janë shteruar mjetet juridike, ka një shpërndarje të barrës së provës. Është detyrë e organit shtetëror që pretendon mosshkrimin e mjeteve juridike, të bindë Gjykatën që mjete ishte efektiv, i disponueshem në teori dhe në praktikë në kohën përkatëse, domethënë se mjete ishte i aksesueshem, dhe i tillë që mund të ofronte kompensim në lidhje me ankesat e kërkuarit. Nga ana tjetër, me përmbushjen e kësaj barre prove nga ana e organeve shtetërore, është detyrë e kërkuarit të vërtetojë se mjete i ofruar nga organet shtetërore, në fakt është shteruar. Këtë qëndrim ka mbajtur edhe GJEDNJ-ja (*shih vendimin e pranueshmërisë në çështjen Lehtinen v. Finland, aplikimi nr. 39076/97, par.7*).

Në kuadrin e standardeve të parashtruara më sipër, Gjykata Kushtetuese duhet të përcaktojë nëse, në sistemin juridik të vendit, kërkuarja, për të parashtruar një ankesë për tejzgjatje të procesit gjyqësor, ka pasur në dispozicion mjete juridike efektive në kuptim ose të parandalimit të shkeljes së pretenduar, ose të pengimit të vazhdimin të kësaj shkeljeje, ose të ofrimit të një riparimi/kompensimi të përshtatshëm të shkeljes së ndodhur.

Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese konstaton se sistemi juridik i vendit nuk parashikon ndonjë mjet juridik të veçantë, të cilin mund ta përdorte kërkuarja për të kërkuar riparimin e zgjatjes së tepruar të procesit gjyqësor. Një gjë e tillë është konstatuar edhe nga GJEDNJ-ja, në vendimin dt.23.10.2007, *Gjonboçari kundër Shqipërisë, apl. Nr.10508/02, par.77*, - në të cilin është shprehur se, duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Gjykata vëren se Qeveria pranoi, veç ankesës kushtetuese, se sistemi juridik shqiptar nuk parashikonte një mjet të veçantë juridik, të tillë si ato të cilëve u referohet Gjykata në *Kudla* (cituar më sipër), të cilin aplikanti mund ta kishte përdorur për riparimin e zgjatjes së tepruar të procesit. Të njëjtën gjë GJEDNJ-ja e ka konstatuar edhe në vendimin *Marini kundër Shqipërisë, datë 7.7.2008, apl. Nr.3738/02, par. 154*; në vendimin *Hamzaraj kundër Shqipërisë, datë 3.2.2009, par.30, apl. nr.45264/04*, në të cilin shprehet se Gjykata rikujton konstatimin në vendimin e saj datë 23.10.2007, *Gjon Boçari kundër Shqipërisë, apl. Nr.10508/02, par.77*, ku ka konstatuar se në sistemin e brendshëm juridik nuk ka pasur mjete



juridike efektive lidhur me tejzgjatjen e procesit; për pasojë, aplikanti shkarkohet nga shterimi i mjeteve të brendshme.

a) Avokati i Përgjithshëm i Shtetit ka pretenduar se *kërkuesja* nuk i ka shteruar mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtës së saj, sepse ajo nuk ka një vendim gjyqësor përfundimtar që të cenojë të drejtat e saj kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese vëren se ky prapësim buron nga këndvështrimi se mjeti juridik për mbrojtjen e së drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm përthithet nga mjeti juridik për mbrojtjen e së drejtës për një gjykim të drejtë dhe si rrjedhim nuk mund të ushtrohet i pavarur prej tij. Në vlerësim të Gjykatës, ky këndvështrim bie në kundërshtim me kriteret e vendosura nga GJEDNJ-ja (*shih vendimin datë 26.10.2000 Kudla v. Poland, apl. nr.30210/96, par.156*).

Për sa më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson se mund të merren në shqyrtim nga kjo gjykatë edhe kërkesat e individëve, për cenimin e së drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm, pavarësisht se gjykimi për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese dhe ligjore të tyre ende nuk ka përfunduar në të gjitha shkallët e gjyqimit prej gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

b) Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, si shkak të prapësimit të tij mbi pranueshmërinë, ka parashtruar edhe pretendimin se *kërkuesja mund të ankohej për tejzgjatjen e procesit duke ngritur padi në gjykatë*, në mbështetje të ligjit nr. 8510 datë 15.7.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”.

Lidhur me këtë pretendim, Gjykata Kushtetuese duhet të vlerësojë nëse në kuptim të Neneve 131/f të Kushtetutës, si dhe neneve 13 e 35 të KEDNJ-së, ngritja e një padie të tillë, përbën një mjet juridik efektiv për të mbrojtur dhe rivendosur të drejtën për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm.

Gjykata Kushtetuese, bazuar në sa më sipër, çmon se ligji nr. 8510 datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore” ka për objekt rregullimin e përgjegjësisë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore, përgjegjësi që mund të lindë si pasojë e veprimtarisë administrative të tyre, dhe jo parashikimin e mundësisë për të pretenduar cenimin dhe për të rivendosur të drejtën kushtetuese për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, e drejtë kjo që konsumohet brenda kuadrit të një procesi gjykimi të zhvilluar prej gjykatave të pushtetit gjyqësor. Gjykata Kushtetuese arrin në këtë konkluzion referuar parimeve që udhëheqin këtë ligj, procedurave që parashikohen prej tij, si dhe termave dhe koncepteve të përdorura prej këtij ligji, si p. sh. parimit të përgjegjësisë civile prej organit të administratës shtetërore që ka shkaktuar dëmin (nenet 1, 2, 3 të ligjit), parimit të përgjegjësisë vetjake të punonjësve të organeve të administratës shtetërore (neni 4), procedurës së përcaktimit të dëmshpërblimit (neni 11), procedurës për kërkimin dhe përmbushjen e dëmshpërblimit (neni 18).

Në vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese, po të pranohet që ligji i mësipërm përbën bazë të mjaftueshme ligjore për të kërkuar rivendosjen e së drejtës kushtetuese për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, si dhe pagimin e dëmit jashtëkontraktor të shkaktuar nga vonesa në gjykim, do të arrihet rrjedhimisht në konkluzionin e pranimit, qoftë edhe parimisht, të përgjegjësisë civile të gjyqtarëve për vendimet që ata japin në kuadër të një gjykimi. Pranimi i kësaj përgjegjësie, qoftë edhe parimisht, do të binte në kundërshtim me parimin e pavarësisë së gjyqtarëve (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese, nr. 11, datë 2.4.2008*).

Si rrjedhim, Gjykata Kushtetuese çmon se ligji nr. 8510, datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore” nuk përbën një mjet juridik për të rivendosur të drejtën kushtetuese për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, dhe për këtë arsye, e konsideron të pathemeltë prapësimin mbi pranueshmërinë të ngritur nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.

c) Avokati i Përgjithshëm i Shtetit si shkak prapësimi mbi pranueshmërinë ka parashtruar gjithashtu se, kërkesja mund të kërkonte zbatimin e drejtpërdrejtë të neneve 15/2 e 44 të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese vëren se, sipas nenit 15/2 Kushtetutës, *organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre*”, ndërsa sipas nenit 44 të Kushtetutës *“kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore.”*

Për sa u përket dispozitave të mësipërme, Gjykata Kushtetuese thekson se, neni 15/2 i Kushtetutës ka karakter të përgjithshëm, gjë që mund edhe të lejojë që e drejta dhe detyrimi kushtetues që ato mbartin të mund të përfshijë si organet e administratës shtetërore që i përkasin degës së pushtetit ekzekutiv, ashtu edhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Në vlerësimin e Gjykatës, karakteri i përgjithshëm i nenit 15/2 të Kushtetutës, nuk mund të bëjë që kjo normë veçmas, në vetvete, të përbëjë bazë juridike të mjaftueshme për të pretenduar cenimin dhe rivendosur të drejtën kushtetuese për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm. Ndërsa, për sa i përket nenit 44 të Kushtetutës, Gjykata çmon se për shkak se e drejta që njeh dhe sanksionon ky nen, duhet të realizohet në përputhje me ligjin, kjo e drejtë që buron nga Kushtetuta, është subjekt i rezervës ligjore. Për pasojë, dispozita kushtetuese në fjalë nuk mund të zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Pikërisht, bazuar në këtë detyrim kushtetues, legjislatori ka miratuar ligjin nr. 8510, datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”, ligj i cili, siç është parashtruar më sipër, ka për objekt rregullimin e përgjegjësisë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore. Mirëpo ky ligj, në vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese, nuk parashikon mundësinë për të pretenduar cenimin dhe rivendosur të drejtën kushtetuese për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, e drejtë që konsumohet brenda kuadrit të një procesi gjykimor të zhvilluar prej gjykatave të zakonshme.

Si rrjedhim, Gjykata Kushtetuese konkludon se dispozitat e mësipërme kushtetuese të referuara nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, nuk mund të zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë për të kërkuar në gjykatë riparimin/rivendosjen e të drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

d) Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, për të kundërshtuar pranueshmërinë për shqyrtim të kërkesës, pretendoi gjithashtu se, për rivendosjen e të drejtës kushtetuese për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm, *kërkesja mund të invokonte edhe nenin 467/a të Kodit të Procedurës Civile.*

Lidhur me këtë pretendim, Gjykata Kushtetuese vëren se dispozita e mësipërme parashikon se: *“Gjykata e apelit, kur prish vendimin, nuk mund ta kthejë çështjen për rigjykim për të dytën herë, por e shqyrton vetë si gjykatë e shkallës së parë. Kur vendimi priset për shkak të moszbatimit të detyrave të caktuara nga gjykata më e lartë, pa u marrë vendim i veçantë sipas nenit 467 të këtij Kodi, gjykata e apelit, me kërkesë të palëve, ngarkon trupin gjykues përkatës me shpenzimet e bëra për këtë shkak”*. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, në këtë aspekt parashtrroi se, paragrafi i dytë i kësaj dispozite përbënte bazë të mjaftueshme ligjore për të pretenduar cenimin dhe rivendosur të drejtën kushtetuese për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm.

Gjykata Kushtetuese, referuar parashikimeve të dispozitës së sipërcituar, çmon se kjo dispozitë, në paragrafin e parë të saj, synon të garantojë shmangien e tejzgjatjes së paarsyeshme të gjykimit, ndërsa në paragrafin e dytë të saj, i referohet shpenzimeve gjyqësore, të cilat si institut rregullohen nga nenet 102 – 110 të KPC-së. Nga kuptimi dhe struktura e dispozitave që përbëjnë këtë institut, rezulton se këto të fundit nuk përfshijnë asnjë prej aspekteve dhe karakteristikave që, sipas standardeve të përcaktuara nga GJEDNJ-ja, duhet të përmbushë një mjet juridik i destinuar për të mbrojtur dhe rivendosur të drejtën për t’u gjykuar brenda një afati të caktuar.

Për pasojë, Gjykata Kushtetuese çmon se kjo dispozitë nuk përbën një mjet juridik të destinuar për të mbrojtur dhe rivendosur të drejtën për t’u gjykuar brenda një afati të caktuar.



e) Gjatë shqyrtimit kushtetues u parashtrua edhe pretendimi se *kërkuesja mund t'i ishte drejtuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë* për t'u ankuar ndaj veprimeve të trupit gjykues të kryera në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, të cilat i kishin cenuar asaj të drejtën për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm.

Gjykata, për sa i përket këtij pretendimi, bazuar në kriteret e përcaktuara nga GJEDNJ-ja, vëren se në kuptim të nenit 13 të Konventës, autoriteti para të cilit mund të parashikohet mundësia e fillimit të një procesi për të provuar cenimin e së drejtës, jo domosdoshmërisht mund të jetë një autoritet gjyqësor (gjë që nënkupton edhe mundësinë e të qenurit të tij një autoritet administrativ), por nëse nuk është i tillë, pushtetet e tij dhe garancitë të cilat ai ofron, janë kryesore në përcaktimin nëse mjeti përpara tij është efektiv (*shih Silver and Others v. UK, apl. Nr.5947/73, par.113*). Gjykata, në këtë aspekt, referuar kuadrit ligjor në bazë të të cilit është i organizuar dhe funksionon Këshilli i Lartë i Drejtësisë, konkretisht ligjit nr. 8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, vlerëson se ky ligj jo vetëm që nuk plotëson kushtet e veçanta të mjetit juridik për të mbrojtur dhe rivendosur të drejtën për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm në veçanti, por edhe kushtet e përgjithshme të mjetit juridik, të aksesit dhe të efektivitetit të tij në përgjithësi. Konkretisht, sipas këtij ligji, Këshilli të Lartë të Drejtësisë nuk i është njohur pushteti për të vendosur mbi pretendimin e cenimit të kësaj të drejte me anën e vendimeve ligjërish të detyruese, por për të rivendosur të drejtën e shkelur, qoftë nëpërmjet një vendimi që të shpejtonte gjykimin duke parandaluar tejzgjatjen vazhduese të tij, qoftë apo edhe nëpërmjet një vendimi me natyrë kompensuese, si kompensim i dëmit të ardhur nga tejzgjatja e paarsyeshme e gjykimit. Një qëndrim të tillë ka mbajtur GJEDNJ-ja, kur shteti përkatës kishte referuar si mjet juridik efektiv një organ të cilit i mungonte pushteti për të marrë vendime ligjërish të detyrueshme (*shih vendimin datë 26.3.1987 Leander v. Sweeden, apl. No.9249/81, par.80, 81 e 82; vendimin datë 03.12.2003 Hartman v. Czech Republic, apl. nr.53341/99, par.61-66*).

Bazuar sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në konkluzionin se mjetet juridike të referuara nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit nuk përmbushnin standardet e të qenit efektiv, dhe për pasojë, vlerëson si të pathemeltë kundërshtimin e ngritur prej tij mbi pranueshmërinë e kërkesës për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike.

*III. Lidhur me pretendimin për shkeljen e të drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm (neni 42/2 të Kushtetutës)*

*Kërkuesja* ka pretenduar cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregull ligjor, si rezultat i moszhvillimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, në shkelje të nenit 42/2 të Kushtetutës.

*Avokati i Përgjithshëm i Shtetit*, në vlerësimin e meritës së pretendimit të kërkueses, duke u mbështetur në kriteret e përcaktuara nga GJEDNJ-ja lidhur me arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor, ka theksuar se fakti që, në çështjen në shqyrtim, përveç palës paditëse dhe të paditur ka pasur edhe palë të treta, si dhe fakti se gjatë kohës që çështja ishte në gjykim kanë ndodhur disa ndryshime ligjore, kanë ndikuar në kompleksitetin e çështjes. Po kështu, sipas tij, kërkuesja vetë apo nëpërmjet avokatëve të saj mbrojtës, ka ndikuar në zvarritjen e procesit gjyqësor.

Ndërsa lidhur me sjelljen e autoriteteve sipas Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, në rastin në shqyrtim, institucioneve shtetërore përkatëse, nuk mund t'i atribuohet zvarritja e procesit.

*Gjykata Kushtetuese* rithekson se arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së, sipas së cilës arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuesit, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që passjell për kërkuesin kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit (*shih vendimin nr.18, datë 19.7.2005 dhe nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

Lidhur me periudhën *e kohës që duhet marrë në konsideratë*, Gjykata Kushtetuese konstaton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e ka filluar shqyrtimin e çështjes më datë 6.12.2006 dhe deri më datën 9.5.2011, kur Gjykata Kushtetuese filloi shqyrtimin kushtetues të saj, ende nuk kishte dalë me një vendim themeli në lidhje me pretendimin e kërkueses, duke e shpallur të bazuar ose jo atë.

Për sa u përket *kompleksitetit të çështjes*, Gjykata Kushtetuese konstaton se mosmarrëveshja objekt i gjykimit të zakonshëm është e natyrës administrative, gjykimi i të cilave parashikohet dhe rregullohet prej neneve 320-333 të KPC-së. Kjo mosmarrëveshje shfaq si aspekte ligjore, ashtu edhe aspekte faktike. Aspekti i ligjshmërisë së veprimtarisë administrative objekt gjykimi, që është sintetizuar në objektin e padisë, implikon zbatimin e legjislacionit mbi urbanistikën, legjislacion ky gjerësisht i zbatueshëm, i cili ka si parakusht të tij aspektin faktik, të pozicionimit gjeografik dhe kondicioneve urbane të sendit objekt gjykimi, konstatimi dhe sqarimi i të cilave kërkon njohuri të posaçme topografike/urbanistike, gjë e cila megjithatë është lehtësisht e realizueshme dhe është realizuar në rastin konkret me anë të caktimit të ekspertimit të fushës përkatëse.

Për sa i përket palëve pjesëmarrëse në këtë gjykim, Gjykata Kushtetuese konstaton se përveç palëve fillestare, kërkueses dhe KRRTRSH-së, kanë qenë dhe Avokatura e Shtetit, Drejtoria e Policisë së Ndërtimit/sot Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar dhe Dega e Policisë së Ndërtimit Berat/ sot Inspektorati Ndërtimor Urbanistik pranë Bashkisë së Beratit, pra një numër jo i lartë, dhe se të gjitha këto palë, përjashtoj vetëm kërkuesen, janë institucione qendrore dhe vendore të administratës shtetërore të cilat në bazë të nenit 15/2 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të Kodit të Procedurave Administrative, kanë për detyrim që gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, të mbrojnë në çdo rast interesin publik, si dhe të drejtat dhe interesat kushtetues dhe ligjorë të personave privatë, duke kontribuar në realizimin e tyre.

Gjykata Kushtetuese konstaton gjithashtu se, gjatë shqyrtimit gjyqësor të kësaj mosmarrëveshjeje, si pasojë e miratimit të ligjit nr. 10119 datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit” dhe e nxjerrjes së vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 119 datë 13.1.2009, Drejtoria e Politikave të Planifikimit Urban në Ministrinë e Punëve Publike dhe të Transportit që përfaqësonte KRRTRSH-në ka pushuar së ekzistuari dhe në vend të saj është krijuar Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit. Megjithatë, në vlerësim të Gjykatës Kushtetuese, kjo ngjarje e ndodhur gjatë procesit gjyqësor, nuk ka kontribuar në rritjen e kompleksitetit të çështjes dhe për rrjedhojë edhe në tejzgjatjen e saj, duke shkaktuar vetëm kalimin procedural në bazë të nenit 199 të KPC-së, i cili në rastin konkret ka ndodhur pa qenë nevoja që të pezullohej gjykimi sipas neneve 297-298 të KPC-së.

Sa më sipër, Gjykata Kushtetuese, ndryshe nga sa pretendon dhe prapëson Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, vlerëson se mosmarrëveshja, objekt i gjykimit të zakonshëm, nuk shfaq ndonjë kompleksitet të veçantë që të mund të justifikonte këtë kohëzgjatje të saj.

Lidhur me *sjelljen e autoriteteve*, nga materialet e dosjes rezulton që deri në datën e shqyrtimit të kësaj kërkesë në seancë plenare nga Gjykata Kushtetuese, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë janë zhvilluar gjithsej 36 seanca gjyqësore, ku hapësira kohore nga një seancë tek tjetra rezulton të paktën të jetë një muaj, duke shkuar në disa raste deri në tre muaj (*shih seancat vijuese të datave 30.1.2007, 14.3.2007, 27.4.2007, 1.6.2007*), një praktikë kjo që bazuar në llojin dhe natyrën e mosmarrëveshjes në gjykim si dhe në parashikimin ligjor të nenit 327 të KPC-së, në vlerësim të Gjykatës, është haptazi në shkelje të parimit të zhvillimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm.

Gjykata Kushtetuese, lidhur me shkaqet e shtyrjes së seancave nga materialet e dosjes, konstaton se ato janë shtyrë për shkak se gjyqtarja ka qenë me raport mjekësor, të padijenisë së palëve si pasojë e mosnjohimit të rregullt të tyre prej nëpunësit gjyqësor, për t’u njohur palët në mungesë ose për t’i dhënë kohë atyre për t’u njohur me aktet e çështjes, për shkak të mosparaqitjes së ekspertës dhe në ndonjë rast nuk është dhënë shkak për shtyrjen e seancës.



Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese thekson se Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (neni 42) si dhe KEDNJ-ja (neni 6), vendos detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit, në mënyrë të tillë, që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu dhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë, që të gjithë subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme. Kjo detyrë e gjykatave gjen artikullimin e saj edhe në dispozitat procedurale civile, e konkretisht në nenin 4 të KPC-së sipas të cilit “*gjykata kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor. Për këtë qëllim, në bazë të kompetencave që i jep ky Kod, vendos për afatet dhe urdhëron marrjen e masave të nevojshme*” dhe në nenin 171/a të KPC-së sipas të cilit “*gjykata ushtron të gjitha të drejtat e përcaktuara në këtë Kod, që janë të nevojshme për zhvillimin sa më të mirë të procesit gjyqësor. Gjykata cakton seancat dhe afatet brenda të cilave palët dhe personat e tjerë të thirrur prej saj duhet të kryejnë aktet procedurale dhe veprimet e tjera të kërkuara prej saj*”.

Në lidhje me këtë aspekt, Gjykata Kushtetuese rithekson se për sa i përket sjelljes së autoriteteve, edhe pse kuadri procedural civil ka parashikuar parimin se iniciativat procedurale u takojnë palëve (neni 2 i KPC-së), kjo nuk i shkarkon gjykatat nga detyrimi për të siguruar një gjykim të shpejtë, siç kërkon neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i KEDNJ-së. Në këtë drejtim edhe GJEDNJ-ja ka mbajtur të njëjtin qëndrim (*shih vendimi datë 8.6.2006 “Surmeli kundër Gjermanisë”, apl. Nr. 75592/01, par.129*).

Gjykata, referuar sa më sipër vlerëson se, gjykimi i kësaj çështje është tejzgatur për shkaqe që i ngarkoheshin sjelljes së autoriteteve shtetërore në përgjithësi, dhe konkretisht trupit gjykues/gjyqtarës së çështjes, nëpunësit gjyqësor, dhe të paditurit/personave të tretë, organe këto të gjitha të pushtetit publik.

Për sa i përket sjelljes së kërkuases, edhe pse nga materialet e dosjes rezulton se seancat e datave 27.4.2007, 9.7.2007, 3.10.2007 dhe 4.4.2008, janë shtyrë për shkaqe që i ngarkoheshin kërkuases, përsëri në vlerësim të Gjykatës, këto shkaqe lidhen më së shumti me përmbushjen dhe ushtrimin e të drejtave të saj procedurale, të parashikuara nga KPC-ja si *p. sh.* rregullimi i të metave të padisë, plotësimi i bazës ligjore të saj, parashtrimi i provave mbi të cilat mbështetj kërkitimi i ngritur, apo edhe me pamundësinë objektive për të ndjekur seancën gjyqësore, për shkak se mbrojtësit e saj në të njëjtën ditë dhe orë ndodheshin në gjykime të tjera. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese përsërit se, për sa i përket *sjelljes së kërkuases*, përdorimi nga ana e saj i të gjitha procedurave të parashikuara nga e drejta e brendshme, me qëllim sigurimin e mbrojtjes, nuk mund të përdoret si argument kundër saj (*shih vendimin e sipërcituar të Gjykatës Kushtetuese nr. 9, datë 1.4.2009*).

Në këto kushte, Gjykata, referuar materialeve të dosjes konstaton se në to nuk rezulton ndonjë provë që të tregojë kryerjen e ndonjë sjelljeje vonuese nga ana e kërkuases, gjë që të ketë kontribuar në tejzgjatjen e këtij procesi.

Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se padia e kërkuases nuk është gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, duke i shkelur të drejtën për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f të Kushtetutës dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm, në shkelje të nenit 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 6 të KEDNJ-së.
- Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Admir Thanza, Sokol Berberi, Petrit Plloçi.

Anëtarë kundër: Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj.

MENDIM PAKICE

1. Jemi kundër vendimit të shumicës për pranimin e kërkesës, për këto arsye.
2. Kërkesja Adelina Koliqi ka vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me një kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e moszhvillimit të gjykimit të çështjes së saj, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, brenda një afati të arsyeshëm.
3. Ne gjyqtarët në pakicë vërejmë se, Gjykata Kushtetuese vendosi zhvillimin e gjykimit të kësaj kërkesë në seancën gjyqësore të datës 9.5.2011. Në këtë seancë nuk u paraqit as kërkesja, dhe as përfaqësuesi i saj (i emëruar me prokurë të posaçme), edhe pse ishin njoftuar rregullisht nga sekretaria gjyqësore. Për këtë arsye, Gjykata Kushtetuese vendosi të shtyjë zhvillimin e gjykimit në datën 2.6.2011, duke bërë edhe njoftimet përkatëse për palët në gjykim. Në seancën gjyqësore të datës 2.6.2011, përsëri nuk u paraqit as kërkesja, dhe as përfaqësuesi i saj, i cili paraqiti edhe një kërkesë për shtyrjen e seancës, për arsye familjare. Gjykata Kushtetuese, pasi mori në shqyrtim këtë kërkesë, vendosi mospranimin e saj, pasi shkaqet e ngritura ishin të paarsyeshme, dhe vendosi vazhdimin e gjykimit në mungesë të kërkujes dhe mbrojtësit të saj.
4. Ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, në nenin 1, paragrafi i dytë, parashikon se: *“Për çështje që lidhen me procedura që nuk rregullohen nga ky ligj, Gjykata Kushtetuese merr parasysht edhe dispozitat ligjore që rregullojnë procedurat e tjera, duke marrë në konsideratë natyrën ligjore të çështjes.”* Në këtë kuptim, neni 179, paragrafi i parë, i Kodit të Procedurës Civile (KPC) parashikon se: *“Nëse paditësi ose asnjë nga palët, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqiten, si në veprimet përgatitore ashtu edhe seancën gjyqësore dhe rezulton se kanë dijeni rregullisht, gjykata apo gjyqtari i vetëm vendos pushimin e gjykimit.”*
5. Në kushtet e mësipërme, ne gjyqtarët në pakicë vlerësojmë se në rastin konkret plotësohen kriteret për pushimin e gjykimit të çështjes. Kërkesja Adelina Koliqi dhe përfaqësuesi i saj janë njoftuar rregullisht dhe kanë marrë dijeni për datën e zhvillimit të seancave gjyqësore, sipas procedurës që parashikon neni 38, pika 3, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Edhe pse asnjëri prej tyre nuk u paraqit në seancën e datës 9.5.2011, Gjykata Kushtetuese vendosi të shtynte gjykimin për t’u dhënë mundësi atyre të dëgjoheshin para kësaj Gjykate. Përveç kësaj, në seancën e datës 2.6.2011 Gjykata Kushtetuese i vlerësoi shkaqet e paraqitura nga përfaqësuesi i kërkujes për shtyrjen e gjykimit si të paarsyeshme. Në këto rrethana, vlerësojmë se përderisa kërkesja dhe përfaqësuesi i saj kishin dijeni për zhvillimin e gjykimit dhe përderisa ata nuk u paraqitën në seancë gjyqësore, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, në bazë të nenit 179 të KPC-së, Gjykata Kushtetuese duhej të vendoste





pushimin e gjykimit të kësaj çështjeje. Të njëjtin qëndrim Gjykata Kushtetuese e ka mbajtur edhe më parë në vendimin e saj nr.27, datë 15.12.2008. Për më tepër, në gjyqtarët në pakicë vlerësojmë se, në rastin konkret, nuk ekziston ndonjë interes publik që do t'i impononte Gjykatës Kushtetuese zhvillimin e këtij gjykimi edhe në mungesë të palës kërkuese.

Anëtare: Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 15.3.2012  
Doli nga shtypi më 17.3.2012

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2012

Çmimi 32 lekë